



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 820/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me apelin e Florije Mani, anëtare për Kuvendin Komunal në Kaçanik, nga radhët e subjektit politik Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Florije Mani, anëtare për Kuvendin Komunal në Kaçanik, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, me shenjën ZL.Anr.820/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel ZL.Anr.820/2017 me datën 10.11.2017, nga Florije Mani, anëtare për Kuvendin Komunal në Kaçanik, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Kaçanik, në të cilën pretendon se në këto vendvotime ka pasur më pak vota: 0701D/03R, 0713D/01R, 0703D/01R, 0701D/05D, 0706D/02R, 0704D/01R. Më tej thekson se është bërë gabim gjatë rinumërimit, andaj kërkon që të rinumërohen edhe njëherë votat pasi që për 5 vota nuk mund të certifikohet nga kundër kandidatja Kaltrina Tafili e cila ka 92 vota, ndërsa parashtruesja e apelit ka 87 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankueses i refuzoi si të pabazuara pasi gjeti se Vendvotimet me numër 0701D/03R, 0713D/01R, 0703D/01R, 0701D/05D, 0706D/02R, 0704D/01R janë rinumëruar në QNR, me vendim të KQZ-së me numër 2146/2017 të datës

01.11.2017, prandaj nga arsyet e lartëcekura PZAP nuk u lëshua në vlerësimin e meritave të apelit.


Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.820/2017 më datën 11.11.2017.

Kryesues i Panelit

Rafet Haxhai



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*